

VENDIM
Nr.69, datë 30.9.2010

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR GARANCITË FINANCIARE TË
PJESËMARRËSVE PËR REGJISTRIMIN NË TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të pikës III.2.4, kapitulli III të “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, të miratuara nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s me vendimin nr.68, datë 23.6.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.9.2010, pasi shqyrtoi draftin e rregullave për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike dhe relacionin përkatës të drejtorive teknike,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregullat për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike (rregullat bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta